



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 12 gusht 2014
Nr.ref.: RK 696/14

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr.

KI117/12, KI118/12, KI119/12, KI121/12, KI124/12, KI125/12

Parashtrues

Fatmire Berisha, Musa Pllana dhe Ismije Pllana, Vesel Bardhi, Ramë Berisha dhe Dragica Stanojević

Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Vushtrri të Republikës së Kosovës, C. nr. 215/06, të 3 korrikut 2006

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesat u dorëzuan nga parashtruesit si në vijim:
KI117/12 Fatmire Berisha, me vendbanim në Mitrovicë;
KI118/12 Musa dhe Ismije Pllana, me vendbanim në Vushtrri;
KI119/12 Vesel Bardhi, me vendbanim në Vushtrri;
KI121/12 Ramë Berisha, me vendbanim në Vushtrri;
KI124/12 Dragica Stanojević, me vendbanim në Vushtrri dhe
KI125/12 Zlatana Nikić, me vendbanim në Vushtrri.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit në kërkesë ankohen për mospërmbartimin e Aktgjykimit të Gjykatës Komonale në Vushtrri të Republikës së Kosovës, C. nr. 215/06 (në tekstin e mëtejme: Gjykata Komonale në Vushtrri), të 3 korrikut 2006, i cili është pranuar nga parashtruesit në një datë të pacaktuar.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së mospërmbartimit të aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Komonale në Vushtrri.

Baza juridike

4. Kërkesat bazohen në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47.2 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe në rregullin 56 (2) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Parashtruesit i dorëzuan kërkesat e tyre ndërmjet 20 nëntorit 2012, dhe 31 dhjetorit 2012.
6. Më 1 janar 2013, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, me Vendimin Nr. GJR. KI117/12, caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin Nr. KSH. KI117/12, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Ivan Čukalović dhe Artur Rama-Hajrizi.
7. Më 19 prill 2013, kërkesat iu komunikuan Gjykatës Themelore në Vushtrri (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore).
8. Më 16 janar 2013, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese nxori Vendimin (KI117/12, KI118/12, KI119/12, KI121/12, KI124/12 dhe KI125/12), për bashkimin e kërkesave.
9. Më 22 nëntor 2013, në pajtim me rregullin 37 të Rregullores së punës, Gjykata i informoi parashtruesit për bashkimin e kërkesave.
10. Parashtruesit nuk kanë paraqitur asnjë kundërshtim kundër vendimit për bashkimin e kërkesave.
11. Më 11 shkurt 2014, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Parashtruesit ishin punonjës në Ndërmarrjen shoqërore "Çyçavica" deri në vitin 1992.

13. Në bazë të dokumenteve të dorëzuara, bazuar në Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Vushtrri, C. nr. 215/06, të 3 korrikut 2006, NSH “Çyçavica” në Vushtrri ishte urdhëruar t’ua rikthejë të gjitha të drejtat e pagave për periudhën nga viti 1992 deri më 1999, me një kamatë prej 4.5% në vit, që nga 29 qershori 2005 deri në pagesën përfundimtare për të gjithë parashtruesit. Pasi që nuk është ushtruar asnjë ankesë kundër tij, vendimi mori formën e prerë më 15 shtator 2006. Megjithatë, ai kurrë nuk u përmbaarua.
14. Parashtruesit e parashtruan kërkesën në Gjykatën Komunale në Vushtrri për përmbaarimin e aktgjykimit të mëparshëm të Gjykatës Komunale, C. nr. 215/06, të 3 korrikut 2006.
15. Më 5 tetor 2006, Gjykata Komunale në Vushtrri vendosi për përmbaarimin e Aktgjykimit C. nr. 215/06, të 3 korrikut 2006 (p. sh., Vendimi E. nr. 845/06, i 5 tetorit 2006, në rastin e parashtrueses së parë, Fatmire Berisha). Llogaria e NSH “Çyçavica” ishte bllokuar dhe “Banka e Re e Kosovës”, dega në Vushtrri, ishte urdhëruar t’ua paguajë parashtruesve shumën e specifikuar së bashku me kamatën e caktuar.

Pretendimet e parashtruesit

16. Parashtruesit pretendojnë se ata kanë punuar në NSH “Çyçavica” në Vushtrri deri në vitin 1991, kur forcat serbe i dëbuan me forcë nga puna dhe i diskriminuan.
17. Parashtruesit pretendojnë se ishin shkelur të drejtat e tyre, të garantuara me Kushtetutë, sepse ata kanë të drejtë në një pjesë të të ardhurave nga privatizimi i NSH “Çyçavica” si një formë e kompensimit për pagat e tyre për periudhën nga viti 1991 deri më 1999.

Pranueshmëria e kërkesës

18. Gjykata vëren se, në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesve, ajo duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesit i kanë përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
19. Sa i përket kërkesës së parashtruesve, Gjykata i referohet rregullit 36 (3) h), i cili përcakton si në vijim: *“Po ashtu, një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet vijuese, kur kërkesa nuk është ratione temporis në pajtim me Kushtetutën”*.
20. Për ta përcaktuar juridiksionin kohor të Gjykatës, është me rëndësi të identifikohet, në secilin rast specifik, koha e saktë e shkeljes së pretenduar. Me këtë rast, Gjykata duhet të marrë parasysh faktet për të cilat parashtruesit ankohen si dhe përmasën e së drejtës kushtetuese që pretendohet të jetë shkelur (shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykimi i Dhomës së Madhe të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Rastin *Blečić kundër Kroacisë*, Kërkesa Nr. 59532/0, e 8 marsit 2006, para. 82).

21. Gjykata vëren se parashtruesit ankohen për moskompensimin e pagave të tyre prej vitit 1992 deri më 1999. Në këtë drejtim, parashtruesit pretendojnë se ka pasur shkelje për shkak të mospërbarimit të Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Vushtrri, C. nr. 215/06, të 3 korrikut 2006.
22. Kjo do të thotë se shkelja e pretenduar e të drejtës së parashtruesve, e garantuar me Kushtetutë, kishte ndodhur para 15 qershorit 2008, gjegjësisht datës kur ka hyrë në fuqi Kushtetuta, nga e cila datë Gjykata ka juridiksion kohor.
23. Për më tepër, në lidhje me rastet e gjykuara nga Gjykata sa i përket pezullimit të procedurës përmbarese, konkretisht në lidhje me rastin Nr. KIO8/09, Sindikata e pavarur e punonjësve të Fabrikës së çelikut - IMK Ferizaj, Aktgjykimi i 17 dhjetorit 2010, Gjykata konsideron se në bazë të dokumenteve të parashtruara dhe të procedurave të përfunduara, kjo kërkesë ndryshon nga rasti i sipërmendur.
24. Gjykata thekson se në fakt ajo është kompetente për shqyrtimin e fakteve të rastit konkret sa i përket pajtueshmërisë së tyre me Kushtetutën, vetëm për atë që ato kanë ndodhur pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës. Megjithatë, Gjykata mund t'i marrë parasysh faktet, që kanë ndodhur para hyrjes në fuqi të Kushtetutës, për atë që mund të konsiderohet se ato kanë krijuar një situatë që shtrihet përtej asaj date, apo që mund të jetë me rëndësi për t'i kuptuar faktet të cilat kanë ndodhur pas asaj date.
25. Lidhur me siç u tha më sipër, në rastin konkret gjendja dallon nga rasti Nr. KIO8/09, Sindikata e pavarur e punonjësve të Fabrikës së çelikut - IMK Ferizaj, Aktgjykimi i 17 dhjetorit 2010. Përkatësisht, Gjykata vëren se parashtruesit nuk kanë bërë asnjë përpjekje që Aktgjykimi i tyre të përmbarohet, pasi që ata kanë pritur 6 (gjashtë) vjet para se të parashtrojnë kërkesat e tyre në Gjykatë. Dhe duke supozuar që parashtruesit nuk kanë pasur mjete efektive juridike sikurse pretendohet, Gjykata vëren se ata kanë qenë të njoftuar për këtë shumë kohë para muajve nëntor/dhjetor 2012, periudhë kjo kur ata i kanë parashtruar kërkesat e tyre, për dallim nga rasti KIO8/09 të cilët e kanë parashtruar kërkesën e tyre më 3 mars 2009, dmth. brenda afatit kohor prej 4 (katër) muajve pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, siç përcaktohet në nenin 56 (Rastet paraprake) të Ligjit.
26. Gjithashtu, parashtruesit është dashur që në mënyrë bindëse të tregojnë se ka pasur përparim të vazhdueshëm dhe konkret përgjatë 10 (dhjetë) viteve të kaluara, që do të mund ta arsyetonte vonesën në parashtrimin e kërkesës në Gjykatë.
27. Nga kjo rrjedh se kërkesa e parashtruesve nuk është *ratione temporis* në pajtim me dispozitat e Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, dhe rregullat 36 (3) h) dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 11 shkurt 2014, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve dhe ta publikoj këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit;
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Altay Suroy

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



prof. dr. Enver Hasani